

Durrës, 1 korrik 2011

NJOFTIM PËR SHTYP

Para dy ditësh drejtuesit e Institucioneve Shtetërore në territorin e Portit detar dhe përfaqësuesit e Shoqërive të Lundrimit zhvilluan një Takim për bashkërendimin e punës me qëllim përmirsimin e performacës portuale si dhe lidhur me përballimin e fluksit të udhëtarëve dhe automjeteve me tragete gjatë sezonit veror.

Nga diskutimi i problematikave të pritshme si dhe nga përvoja e krijuar gjatë viteve të fundit ne vendosëm së bashku të marrim këto masa organizative:

- Të orientojmë sa më mirë udhëtarët dhe mjetet në hapësirat portuale, në mënyrë që koha e qëndrimit të tyre në portin detar të shkurtohet sa më shumë.
- Institucionet që operojnë në hapësirën portuale do të rrisin kapacitetet duke punuar me orare të zgjatura si dhe duke shtuar numrin e sporteleve në shërbim të udhëtarëve dhe automjeteve.
- Autoriteti Portual edhe në bashkëpunim me kompaninë që ndërton Terminalin e trageteve do të vendosë hapësira të tjera më të mëdha në dispozicion të automjeteve gjatë procesit të imbarkimit dhe zbarkimit.
- Mjetet lundruese të udhëtarëve, pra tragetet dhe katamaranët, do të kenë prioritet në hyrje dhe në dalje të basenit portual krahasuar me anijet tregtare të mallrave.
- Punonjësit e Agjencive të lundrimit do të kenë veshje të identifikuara, duke lehtësuar komunikimin e udhëtarëve me ta.
- Do të garantohet korrektesa e orareve të trageteve në nisje dhe në mbërritje në portin detar të Durrësit.

-Për këtë qëllim fillimi i punës për përpunimin e trageteve në mëngjes do të nisë në ora 7.00, një orë më parë se sa orari i deritanishëm.
-Nisja e trageteve në mbrëmje do të bëhet sipas orarit të parashikuar në biletë, pra ora 23.00 dhe jo në orare të tjera.

-Për këtë qëllim janë të lutur të gjithë përdoruesit e portit dhe të trageteve të udhëtarëve në veçanti, që të paraqiten në pikën e kalimit kufitar dhe doganor jo më pak se 30 minuta para orarit të nisjes së mjeteve lundruese.

Institucionet e Autoritetit portual, Doganës, Policisë së kufirit dhe migracionit dhe Administrata e përgjithshme Detare gjetëm mirkuptim të plotë, me synim krijimin e kushteve optimale të lundrimit për udhëtarët dhe automjetet e tyre.

Si gjithmonë ne besojmë në mbështetjen që do të na japin mediat e shkruara dhe vizive për ti bërë të njohura këto masa dhe për të patur mirkuptimin e të gjitha palëve.

